



Titulli i projektit

Pastrimi i Liqenit te Fierzës dhe Zones Perreth tij

Tipi i projektit

Mjedisor / Turistik

Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Kukës

Buxheti i paravlerësuar

150,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Liçeni i Fierzës ka një gjatësi prej 72km dhe sipërfaqe rreth 8,169 ha. Liçeni i Fierzës është i krijuar nga derdhja e lumenjve të Drinit të Bardhë, Drinit të Zi, etj.. Liçeni i Fierzës është i pasur me habitate dhe 13 lloje peshqish, është i përshtatshëm për udhëtime turistike, peshkim, etj.. Me VKM Nr. 88, datë 01.03.1993, bregu i Liqenit të Fierzës është shpallur zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit. Problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane. Pjesa më e madhe e mbetjeve vjen nga rrjedhja e lumenjve të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ato ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës, ambientit përreth, si dhe në shfrytëzimin e terrenit për turizëm balnear dhe aktivitete ujore. Për pastrimin e liqenit janë zbatuar vite më parë grante të vogla të financuara nga donatorë të ndryshëm. Megjithatë kjo nuk ka ndikuar në zgjidhjen e problemit, pasi Liçeni i Fierzës ka një sipërfaqe të madhe dhe pastrimi me anë të mjeteve bashkëkohore kushton shumë. Aktualisht vërehet një kërkesë në rritje për të vizituar këtë potencial natyror të pashfrytëzuar nga banorët, si dhe një interes i shtuar nga pushteti vendor për ta shndërruar në një destinacion turistik. Turizmi dhe mjedisi janë prioritetet kryesore në Strategjinë e Zhvillimit Rajonal 2012-2016 për Qarkun e Kukësit.

Qëllimi/et specifik të projektit


OS1: Të hartohet plani i veprimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e Liqenit të Fierzës

Os2: Të përmirësohen kushtet aktuale të Liqenit të Fierzës, të zhvillohet dhe të ruhet fauna, duke vendosur parametra të përshtatshme për zhvillimin e një atraksioni turistik.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- R1: Sipërfaqe ujore dhe breg liqeni i pastruar;
- R2: Komuniteti ka mundësinë e shijimit të një bregu të pastër nga mbeturinat urbane
- R3: Krijim kushtesh optimale për një faunë të zhvilluar, si dhe për zhvillimin e turizmit
- R4: Peshki i shëndetshëm
- R5: Frekuentim më i madh në liqen
- R6: Mjedis i pastër

PROJEKTI 4



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

1. Vlerësimi i gjendjes aktuale
2. Rekrutimi dhe krijimi i grupit të punës.
3. Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve të grupit të punës
4. Pastrimi i liqenit dhe zonës përreth tij
5. Përgatitja e fletëpalosjeve dhe lançimi në media i fushatës për sensibilizim
6. Bashkëpunim më i gjerë me vendet kufitare nga ku vjen rrjedha e lumenjve

Projekti mendohet të zbatohet për një periudhë 2-vjeçare.

Përfitues të këtij projekti janë banorët e zonës, një numër i konsiderueshëm peshkatarësh, pushuesish, turistësh, grupesh interesi që merren me aktivitete ujore.

Maturimi i projektit

N/A

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e projektit:

- DLDP

Projekti do të zbatohet nga:

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës.
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Vlerësimi i gjendjes aktuale 10,000€

Rekrutimi dhe krijimi i grupit të punës 20,000€

Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve të grupit të punës 10,000€

Pastrimi i liqenit dhe zonës përreth tij 105,000€

Përgatitja e fletëpalosjeve dhe lançimi në media i fushatës për sensibilizim 5,000€